



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura e III-të

Më 25.02.2008, në ora 10:00

Salla N-10

Komisioni për
Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Procesverbal

Mbledhjen e drejtoi

Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit

Morën pjesë:

Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi dhe Zef Morina.

Munguan: Et'hem Çeku, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Berim Ramosaj dhe Mufëra Šinik;

Nga zyra mbështetëse:

Hasan Tahiri, Advie Morina dhe Armend Ademaj;

Pjesëmarrës të tjerë: Vjosa Bajraliu nga NDI-ja; Petrit Hysa nga OSCE-ja, Haxhi Gashi nga USAID-i dhe Lumnije Murati nga Presidenca.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për eficiency e energjisë;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për taksën e vendosjes;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
5. Të ndryshme;

Kryetarja i informoi të pranishmit se kjo mbledhje është ftuar në procedurë të përsheptuar për shkak se për datën 26.02.2008 është paraparë të mbahet seancë e Kuvendit në të cilën dot shqyrtohen në parim tri P. ligje që paragjykohet se Komisioni ynë dot jetë komision raportues. Mospjesëmarrja e anëtarëve të tjerë në këtë mbledhje ndërlidhet dhe arsyetohet nga fakti se anëtarët kanë mundur të mos jen informuar me kohë.

Në vazhdim ajo kaloi në drejtimin e mbledhje duke prezantuar rendin e ditës.

- Rendi i ditës u miratua.

I – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

-Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar të datës 14.02.2008.

II - Shqyrtimi në parim i Projektligjit për eficiencën e energjisë;

Kryetarja Selmani – I informoi të pranishmit se ky P. ligj ka qenë në procedurë të Kuvendit gjatë legjislaturën e dytë. Sipas informatave nga administrata e Kuvendit dhe të dhënat përkatëse i njëjti projektligj, sipas kërkesës së Ministrisë së atëhershme për Energjetikë e Miniera të datës 05.06.2006 dhe sipas propozimit të Komisionit të atëhershëm funksional më 15.06.2006, Kuvendi i Kosovës ia ka kthyer Qeverisë Projektligjin për eficiencën e energjisë, me qëllim të rihartimit dhe respektimit të:

- parimeve të Acquis Communautaire të Unionit Evropian ;
- zbatimit të parimeve të BE-së sidomos kur i referohemi sektorit të energjisë ;
- harmonizimit me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe
- harmonizimit me qëndrimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar;

Tani vërtetohet se P. ligji nuk është rihartuar sipas vërejtjeve, por është procedua i njëjti. Komisioni vlerësoi se: Ministria për Energjetikë e Miniera, implementimin e politikës për shfrytëzimin sa më efikas të energjisë, ka mundur ta realizojë sipas masave dhe akteve nënligjore të parapara me nenin 9, 10 dhe 11 të Ligjit për energji nr. 2004/8,

Në vazhdim Komisioni konstatoi se Ministria nëse dëshiron që këtë materie ta rregullojë me ligj, së pari duhet ta zhvillojë procedurën e ndryshimit të neneve përkatëse (neni 9, 10. dhe 11) të Ligjit për energji, ne të kundërtën kjo lëmi rregullohet me akte nënligjore.

Në vazhdim dhe pas diskutimeve mbështetëse të anëtarëve të tjerë unanimisht u miratua rekomandimi:

Projektligji për eficiencë dhe energji nuk miratohet në parim dhe propozohet t'i kthehet Qeverisë, për veprim ne pajtim me përmbajtjen e rekomandimit.

Kryetarja Selmani, u autorizua për Raportuese në emër të Komisionit për seancën e Kuvendit.

III - Shqyrtimi në parim i Projektligjit për taksën e vendosjes;

Kryetarja Selmani – Në fillim konstatoi se Projektligji është i një rëndësie të veçante ngase rregullon dhe krijon të drejta, obligime e përgjegjësi, P. ligji krijon parakushte

për të hyra nga të hyrat e veprimtarisë përkatëse që në Kosovë është njëra nga veprimtaritë më të hershme, më të shtrira dhe më rentabile.

Pas diskutimeve në parim, anëtarët e Komisionit miratuan vërejtjet parimore:

-Disa dispozita të P. ligjit duhet të vendosen sipas përmbajtjes dhe sipas prioritetit.

-Disa dispozita krijojnë të drejta apo obligime për autoritete administrative duke thënë : “organi i turizmit” ; “organi kompetent “ e tjera . Shprehjet e përgjithshme gjatë shqyrtimit duhet shmangur dhe duhet përcaktuar shprehje të sakta.

Në fund Komisioni me votë unanime miratoi rekomandimin:

Komisioni e miraton në parim P. ligjin për taksën e vendosjes.

Kryetarja Selmani u autorizua për Raportuese në emër të Komisionit për seancën e Kuvendit.

IV - Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

Kryetarja Selmani – kërkoi që debati të bëhet vetëm në parim.

Pas diskutimit të të gjithë anëtarëve Komisioni konstatoi se : çështje esenciale e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është fushë veprimtaria e Agjencionit të themeluar sipas nenit 8 të Ligjit në fuqi dhe themelimi i Këshillit të Agjencionit (nenet 5 dhe 6 të Projektligjit).

Komisioni konsideron se vëmendja kryesore gjatë shqyrtimit të mëtejme duhet përqendruar dhe vlerësuar në qendrueshmërinë ose arsyeshmërinë e themelimit të Këshillit të Agjencisë i cili në fakt mund të ketë edhe implikime buxhetore.

Komisioni këtë çështje e la të hapur dhe dot akordohet me qëndrimin e përgjithshëm në seancën e Kuvendit.

Pas shqyrtimit në parim, Komisioni me votim unanim nxori rekomandimin:

Miratohet në parim Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe procedohet në procedurë të mëtejme.

- Kryetarja Selmani u autorizua për raportuese në emër të Komisionit për seancën e Kuvendit.

Vërejtje dhe propozim.

Në fund Komisioni vlerësoi dhe konstatoi se P. ligjet në përgjithësi kanë lëshime të standardeve tekniko juridike e gjuhësore.

Meqenëse tani në kuadër të administratës së Kuvendit të Kosovës është themeluar Shërbimi për Standardizim dhe Përafrim me legjislacionin e BE-së me ekspertë përkatës, Komisioni funksional kërkon nga Shërbimi për Standardizim dhe Përafrim, që para dhe gjatë shqyrtimit të projektligjeve nëpër komisione, të ofrojë me shkrim këshilla , sugjerime e propozime përkatëse me qëllim që projektligjet në aspektin tekniko juridik të jen në pajtim me standardet tekniko-juridike.

Kjo kërkesë bëhet edhe për shkak të ekonomizimit sa më të mirë të kohës gjatë shqyrtimit, ashtu që komisionet të merren me punë përmbajtjesore.

V – Të ndryshme;

Kryetarja Selmani – Propozoi që gjatë dy-tre muajve në vijim të realizohen disa vizita pune në ministritë dhe në disa ndërmarrje publike që i mbikëqyr Komisioni sipas nenit 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Propozimi u miratua një zëri dhe u zgjodh grupi për hartimin e programit dhe agjendës së vizitave : Myzejene Selmani, Zef Morina dhe Kaqusha Jashari.

Mbledhja përfundoi ne orën 11.00

Kryetarja e Komisionit:
Myzejene Selmani